



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina
Drejtoria e Arsimit



Udhëzues për kandidatët në pozita udhëheqëse të institucioneve edukativo-arsimore për fazën e intervistës

Informata të përgjithshme

Pasi keni qenë të suksesshëm në fazën e listës së ngushtë të procesit të përzgjedhjes, ftoheni që të merrni pjesë në intervistë.

Qëllimi i këtij dokumenti është që të ju jap disa informata rreth mbarëvajtjes së procesit të përzgjedhjes dhe rreth asaj se çka mund të prisni gjatë ditës së intervistave.

Shpallja në uebfaqen e komunës do të ju ofrojë informata rreth kohës kur duhet të mbërrini në vendin ku mbahet intervista. Ju lutemi ndani kohë të mjaftueshme për udhëtimin tuaj dhe kujdesuni që të arrini në kohën e duhur, pasi që mund të mos jetë e mundur të vazhdohet me intervista për kandidatët që vonohen.

Gjatë procesit të intervistimit, do të ketë vëzhgues të ndryshëm nga ambasada britanike, shoqëria civile, pushteti lokal, Këshilli Drejtues i shkollës, përfaqësues të Këshillit të Prindërve të pranishëm gjatë intervistave. Pos këtyre, do të jenë tre anëtarë në Komisionin përgjedhës:

- Një anëtarë nga Drejtoria Komunal për Arsim (DKA) në Prishtinë
- Një anëtarë nga Ministria e Arsimit (MASHTI)
- Një ekspert i jashtëm

Secilit kandidat do t'i ndahen rreth 45 minuta për intervistë. Intervista do të përbëhet nga këto pjesë:

- Prezantimi i kandidatit/es (rreth 5 minuta)
- Prezantimi i planit zhvillimor të shkollës (rreth 15minuta)
- Intervista me pyetje dhe përgjigje (rreth 25 minuta)

Ju lutemi përgatiteni përmbajtjen e prezentimit tuaj para intervistës pasi që nga ju do të kërkohet ta bëni prezentimin në fillim të intervistës. Protokollin e intervistimit dhe mënyrat e pikëzimit mund t'ja gjeni në Formularin C të Udhëzimit Administrativ 151/2020. Të gjitha planet zhvillimore të shkollave mund t'i gjeni në linkun:

<https://prishtinaonline.com/drejtore/arsimit/planet-zhvillimore-ieea>

Pjesa e parë e intervistës - Prezantimi i planit zhvillimor të shkollës

Ju lejohet të merrni çfarëdo shënime me vete që do të ju ndihmojnë ta bëni prezentimin. Prezantimi duhet të jetë në formë gojore, pa Poëerpoint apo ndonjë softuer tjetër për prezantime. Gjatë prezantimit tuaj, ju mund t'i referoheni shënimeve, të cilat duhet të lihen anash kur fillon procesi i intervistimit.

Është përgjegjësi e juaja ta menaxhoni kohën tuaj – nëse nuk e kryeni prezentimin brenda 15 minutash, komisioni do të ndërhyjë dhe të kaloj te pyetjet tjera. Në këtë kohë ju duhet të prezantoni veten si dhe planin zhvillimor të shkollës.

Prezantimi do të vlerësohet në këto fusha, të marra nga Formulari C:

Fusha A: Menaxhimi dhe qeverisja

Situata momentale e institucionit edukativo-arsimor dhe planet e kandidat-it/es për:

- përfshirjen e komunitetit të institucionit edukativo-arsimor dhe funksionimin e organeve qeverisëse të institucionit edukativo-arsimor;
- orientimin strategjik të institucionit edukativo-arsimor të fokusuar në zhvillimin e kompetencave të nxënësve;
- funksionalizimin e aktivave/ekipeve profesionale për zbatimin e nxënies së integruar;
- zhvillimin e institucionit edukativo-arsimor kundrejt nevojave të nxënësve dhe rezultateve të vlerësimit të saj;
- udhëheqjen dhe monitorimin e planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe politikave arsimore.

Fusha B: Kultura dhe mjedisi shkollor

Situata momentale e institucionit edukativo-arsimor dhe planet e kandidat-it/es për:

- hapësirat shkollore – sa janë/si të jenë të sigurta, qasshme, shëndetshme dhe miqësore;
- krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë nxënësit për përvetësimin e kompetencave;
- kulturën dhe mjedisin shkollor – sa janë/si të jenë të favorshme për mësimin e integruar dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;
- përfshirjen e të gjithë komunitetit të institucionit edukativo-arsimor në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit fizik të saj;
- mjedisin e përshtatshëm për mësim efektiv.

Fusha C: Mësimdhënia dhe nxënia

Situata momentale e institucionit edukativo-arsimor dhe planet e kandidat-it/es për:

- sigurimin e përfshirjes aktive të nxënësve dhe prindërve të tyre në proceset e mësimin;
- sigurimin e mësimdhënies së diferencuar për të mbështetur nxënësit në përvetësimin e kompetencave kryesore dhe zhvillimin e potencialit të tyre individual;
- sigurimin e mësimdhënies që mundëson nxënien e integruar;
- angazhimin e palëve të interesit për funksionimin e autonomisë për përdorimin e kurrikulës zgjedhore në mënyrë efektive;
- angazhimin e vazhdueshëm të institucionit edukativo-arsimor në përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe nxënies.

Fusha D: Zhvillimi profesional i mësimdhënësve (ZHPM)

Situata momentale e institucionit edukativo-arsimor dhe planet e kandidat-it/es për:

- përfshirjen e nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve në vlerësimin e nevojave për ZHPM;
- sigurimin që praktikat e ZHPM janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve;
- sigurimin që praktikat e ZHPM janë në funksion të zbatimit të nxënies së integruar;
- sigurimin që institucioni edukativo-arsimor është duke përdorur në mënyrë efektive burimet e saj për aktivitetet e ZHPM-së;
- sigurimin që institucioni edukativo-arsimor është duke monitoruar ndikimin e ZHPM në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.

Fusha E: Performanca e nxënësve

Situata momentale e institucionit edukativo-arsimor dhe planet e kandidat-it/es për:

- angazhimin e nxënësve që t'i kryejnë përgjegjësitë e tyre shoqërore dhe qytetare në klasat e tyre, në institucionin edukativo-arsimor dhe komunitet;
- angazhimin e nxënësve për të arritur dhe përparuar në përfitimin e kompetencave kyçe sipas kurrikulave bërthamë;
- pjesëmarrjen e nxënësve në aktivitete jashtëshkollore;
- angazhuar në vetë-menaxhimin e përparimit të tyre;

Pas prezantimit nuk do të ketë pyetje shtesë nga komisioni, por ju do të vlerësoheni në bazë të kriterëve më lart, bazuar vetëm në prezantimin tuaj. Ju do të vlerësoheni sipas aftësisë suaj për të ofruar përgjigje kredibile të bazuara në informata dhe njohuri.

Pjesa e dytë e intervistës - pyetje dhe përgjigje

Në këtë pjesë të intervistës do të ju bëhen një numër pyetjesh rreth mënyrave se si i keni menaxhuar situatat e caktuara në të kaluarën, rreth njohurive tuaja për sistemin arsimor të Kosovës, si dhe rreth kurrikulës së Kosovës. Kur t'i përshkruani përvojat tuaja nga e kaluara, kujdesuni që të jeni sa më të qartë në përshkrimin e rolit që e keni pasur dhe të sjelljeve/veprimeve tuaja në atë situatë. Gjatë përgatitjes për intervistë e vlen të shqyrtohen pikat në vijim:

- Nga ju do të kërkohet të përshkruani situata specifike nga e kaluara ku ju në mënyrë efektive keni demonstruar një kompetencë të caktuar.
- Gjatë përgjigjes në këto pyetje, me rëndësi është që të jeni **sa më të qartë** rreth pozitës/rolit që **ju** e keni pasur, **aktiviteteve/veprimeve tuaja** specifike dhe arsyeshmërisë suaj për atë qasje.
- Komisioni do të kërkojë nga ju shembuj që demonstrojnë gatishmërinë tuaj për të vepruar në nivel të lartë në përpilimin e strategjive shkollore dhe në menaxhimin që i nevojitet drejtorit të shkollës. Me rëndësi është që, sa më shumë, të zgjidhni shembuj përkatës që e theksojnë këtë.
- Shmanguni përshkrimin të situatave në aspekt të përgjithshëm, apo supozimeve rreth njohurisë së anëtarëve të panelit për përvojën tuaj të kaluar.
- Shmanguni përdorimit të fjalës 'ne' kur ta përshkruani situatën - është me rëndësi për komisionin që ta kuptojë kontributin tuaj specifik.

Secila përgjigje do të vlerësohet karshi kompetencës kryesore relevante për pozitën. Komisioni mund të ju bëjë edhe pyetje rreth asaj se si do të mund t'i menaxhonit disa situata në të ardhmen.

Më poshtë gjeni disa shembuj të pyetjeve që mund t'ju shtrohen gjatë intervistës. ***Veni re:*** këto janë pyetje ilustrative për t'ju ndihmuar që të përgatiteni sa më mirë. Komisioni e rezervon të drejtën të shtrojë pyetje tjera të ngjashme, të cilat ndërlidhen me kategoritë më poshtë, të marra nga Fomulari C.

1. Njohuritë e përgjithshme për sistemin e arsimit në Kosovë (rregulloret, ligjet, udhëzimet administrative, politikat/strategjitë e zhvillimit të mësimdhënies)

- Cilat janë ligjet dhe udhëzimet administrative më të rëndësishme në lidhje me pozitën e drejtorit të shkollës?
- A mund të na jepni një shembull ku ju i keni aplikuar udhëzimet administrative dhe legjislativin e arsimit në punën tuaj të përditshme?
- Na tregoni se si keni zbatuar ndonjë strategji efektive të mësimdhënies, duke i marrë parasysh politikat, rregulloret dhe ligjet në arsim.
- Përshkruani se si i keni përdorur ligjet dhe rregulloret e arsimit për të siguruar efektivitetin e mësimdhënies në shkollën tuaj.
- Na tregoni për ndonjë shembull nga puna juaj se si jeni siguruar se që keni zbatuar legjislativin në fuqi në një rast kur legjislativi kishte potencial të minonte mësimdhënien efektive.
- Përshkruani tre aspektet më të rëndësishme të ligjeve, rregulloreve, dhe strukturave administrative ose politikave/strategjive të zhvillimit të mësimdhënies - dhe si i keni promovuar këto në shkollën/çerdhen tuaj.
- Cilat aspekte të ligjeve, rregulloreve, dhe strukturave administrative apo politikave do të sugjeroni të ndryshohen për ta bërë praktikën e mësimdhënies në Kosovë më efektive?

2. Njohuritë e përgjithshme për problemet dhe zhvelimin e arsimit

- A mund të përshkruani dy sfida sistemike në arsim në Kosovë, me të cilat jeni ballafaquar personalisht? Zgjidhni njerën dhe spjegoni se si do ta zgjidhni në pozitën tuaj si drejtor/e / zv. Drejtor/e?
- A mund të na jepni një shembull ku ju i keni aplikuar praktikën më të mira/reja në fushën e arsimit?
- Na tregoni ndonjë shembull se si jeni kontribuar konkretisht që mësimdhënia të ishte efektive në shkollën tuaj.
- Shpjegoni një rast kur keni kaluar një problem të zakonshëm që mund të pengojë efektivitetin e mësimdhënies.
- Përshkruani një metodë të re arsimimi që keni sjellë në shkollën tuaj
- Shpjegoni se si keni punuar me të tjerët përtej shkollës suaj për të identifikuar dhe ndarë praktika më të mira të mësimdhënies
- Në shkollën apo çerdhen për të cilën keni aplikuar, cilat janë tre pengesat kryesore që do të trajtonit si prioritet për ta bërë arsimin më efektiv?

3. Njohuritë dhe përvoja për zbatimin e Kurrikulës në Kosovë

- Cilat nga kompetencat thelbësore në kurrikulën e Kosovës i konsideroni si më prioritare, dhe pse?
- Si do të siguroheshit që Kurrikula po zbatohet në praktikë më mirë se tani, duke mbështetur në resurset ekzistuese?
- Si keni koordinuar dhe menaxhuar resurse për të siguruar që Kurrikula e Kosovës të zbatohet brenda dikasterit tuaj?
- Na tregoni për ndonjë rast kur ju trajtuat një çështje ku një aspekt i Kurrikulës së Kosovës nuk po zbatohet në mënyrë efektive.
- Përshkruani një situatë ku keni kontribuar në përmbajtjen e Kurrikulës së Kosovës
- Shpjegoni një rast kur ju duhet të vendosnit të ndryshonit mësimdhënien për të siguruar që një aspekt i kurrikulës përmirësohej.
- Na tregoni për një situatë ku ju i keni dhënë përparësi një aspekti të kurrikulës mbi një tjetër.

4. Përvoja paraprake në mentorim të kolegëve

- Na tregoni për një kohë ku keni punuar me një mentor për të përmirësuar performancën tuaj?
- Përshkruani një rast kur ju keni kontribuar në rritjen e kulturës së mentorimit në shkollën tuaj?
- Na tregoni për një rast kur ju dhe një koleg e keni mentoruar njëri-tjetrin
- Na tregoni për një fushë ku keni punuar me një mentor për të përmirësuar performancën tuaj.
- Shpjegoni një marrëveshje të mentorimit të kolegëve që keni krijuar për veten ose të tjerët, duke përshkruar hapat dhe qasjen që keni ndërmarrë.
- Na tregoni se si keni krijuar një kulturë brenda shkollës ku mentorimi i kolegëve ndërmerret nga i gjithë stafi.
- Përshkruani se si keni krijuar politika, praktika dhe struktura për një kulturë të mentorimit të kolegëve
- Na tregoni për një rast kur keni krijuar plan për të gjithë stafin se si të drejtoni dhe të përfitonin sa më shumë nga mentorimi i kolegëve

5. Përvoja paraprake në proceset e zhvillimit të arsimit dhe në menaxhim të projekteve

- Shpjegoni një situatë ku keni identifikuar një projekt që nuk po përmbushte qëllimin e tij, dhe keni ndërhyrë me zgjidhje efektive.
- Na tregoni një rast kur keni marrë iniciativë për të mirën e shkollës, përmes bashkëpunimit me hisedarë jashtë shkollës (donatorë, OJQ, biznese, prindër etj).
- Përshkruani një projekt që keni menaxhuar brenda një konteksti arsimor.
- Na tregoni për një rast kur keni krijuar procese që kërkonin të përmirësonin cilësinë dhe efektivitetin e arsimit
- Na tregoni për një rast kur keni identifikuar një proces që po pengonte në vend që të mbështeste zhvillimin e arsimit brenda institucionit tuaj
- Përshkruani një përmirësim që keni sugjeruar në shkollë/çerdhe dhe se si keni krijuar proceset e duhura për t'u siguruar që ai është bërë në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive

Gjatë intervistës, komisioni do ta përcjellë kohën, për t'u siguruar që ta keni rastin të përgjigjeni në të gjitha pyetjet. Kështu që, nëse e zgjasni me përgjigjet, komisioni do të ju ndërpresë dhe do të vazhdojë me pyetjen e radhës. Kjo bëhet për t'u siguruar që të mos mbeteni pa kohë në dispozicion në fund të intervistës.

Integriteti brenda procesit

Komisioni pret që të gjithë aplikantët të kenë sjellje të niveleve të larta të integritetit gjatë tërë kohës së procesit të vlerësimit. Çdo kandidat që dyshohet për mashtrim, përcjellje të informatave rreth procesit ose përdorim të materialeve të paautorizuara gjatë vlerësimit do të sfidohet nga anëtarët e komisionit.

Suksese!